

VENDIM
Nr.32, datë 26.9.2005

PËR NJOHJEN E PROGRAMIT TË TESTIMIT PROFESIONAL PËR AKTUARET
NË SIGURIME

Në mbështetje të shkronjës “k” të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve” dhe të nenit 66 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Çeljen e kursit të trajnimit të aktualeve në sigurime pranë Autoritetit Mbikëqyrës të sigurimeve.
2. Miratimin e programit të testimit profesional për aktualet në sigurime të paraqitur nga FSVC (Financial Services Voluntary Corps) sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Të pranohet oferta e FSVC-së për të financuar kursin.
4. Ngarkohet Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve të përcaktojë kriteret për dhënien e autorizimit aktualeve në sigurime në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Fakultetin e Ekonomisë.
5. Ky vendim t’i dërgohet FSVC-së, Fakultetit të Ekonomisë dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Tiranë dhe shoqërive të sigurimit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE